

LIGJ
Nr.7662, datë 19.1.1993

PËR SHËRBBIMIN E MBROJTJES SË BIMËVE

Në mëshitetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në këtë ligj:

"Inspektor" nënkupton inspektorin e mbrojtjes së bimëve dhe të karantinës.

"Ministër" nënkupton ministrin e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

"Parazit" nënkupton dëmtuesit, sëmundjet ose barërat e këqia të dëmshme, ose potencialisht të dëmshme për bimët a produktet bimore.

"Parazit karantinor" nënkupton një parazit të rrezikshëm me rëndësi ekonomike për vendin, që nuk është vërejtur ose është vërejtur, por nuk është i përhapur gjerësisht dhe luftohet në mënyrë aktive.

"Pesticid" nënkupton çdo lëndë që përdoret për parandalimin, asgjësimin ose luftimin e çdo paraziti të bimëve. Ky term përfshin edhe rregullatorët e rritjes, desiktantët, defoliantët dhe lëndë të tjera që përdoren për mbrojtjen e bimëve e të produkteve bimore.

"Regjistrim" nënkupton procesin e miratimit të shitjes e të përdorimit të një pesticidi nga autoriteti qeveritar përgjegjës, që bazohet në vlerësimin e të dhënave shkencore të plota, të cilat vërtetojnë se pesticidi është efektiv për qëllimet e përdorimit dhe nuk përbën rrezik për njerëzit, kafshët e mjedisin.

"Zonë" nënkupton vendin ku kultivohen, ruhen e transportohen bimë ose produkte bimore.

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e bimëve e në veçanti i bimëve bujqësore nga parazitët dhe shkaqet joparazitare; mbrojtja e produkteve bimore nga organizmat dëmprurës; mënjanimi i rreziqeve për shëndetin e njerëzve e të kafshëve, që mund të vijnë nga përdorimi i pesticideve dhe masat e tjera të mbrojtjes së bimëve, si dhe zbatimi i akteve juridike ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së bimëve.

Neni 3

Ministri me urdhër shpall listën e:

a. parazitëve karantinorë;

b. parazitëve më të rrezikshëm, kontrolli dhe luftimi i të cilëve është i detyruar dhe i vazhdueshëm, dhe bën ndryshime sa herë del e domosdoshme.

KREU II
LUFTIMI I PARAZITËVE TË BIMËVE

Neni 4

Gjithë personat fizikë e juridikë që kultivojnë, prodhojnë, magazinojnë, përpunojnë e tregtojnë bimë e produkte bimore, janë të detyruar të marrin disa masa paraprake kundër parazitëve të bimëve, si dhe të parandalojnë shumëzimin dhe përhapjen e tyre.

Ata janë të detyruar të vrojtojnë bimësinë, tokën dhe produktet bimore për shfaqjen e parazitëve dhe t'i luftojnë ata me metodat, mjetet e pesticidet e lejuara nga dispozitat në fuqi.

Neni 5

Kur përhapja dhe shtimi masiv i një paraziti paraqet rrezikshmëri, inspektori ose agronomi i mbrojtjes së bimëve në komunë detyron, nëpërmjet një urdhri, prodhuesin të zbatojë masa të veçanta luftimi. Nëse prodhuesi nuk zbaton urdhrin, masat e nevojshme të luftimit kryhen nga organet e mbrojtjes së bimëve me shpenzimet e prodhuesit.

Neni 6

Kur gjatë kultivimit një lloj ose kultivar bëhet burim infeksioni, përhapja e të cilit nuk mund të kufizohet me metoda të tjera, pronarët janë të detruar t'i kufizojnë ose zëvendësojnë plotësisht ato me lloje a kultivarë më të qëndrueshëm.

Neni 7

Në rastet e infeksionit e të përhapjes masive të një paraziti, luftimi i të cilit kërkon mobilizimin e një sasive të madhe mjetesh teknike e presoneli shërbyes, ministri ka të drejtë të mobilizojë mjetet teknike dhe makineritë, së bashku me personelin shërbyes nga çdo pronar që i disponon ato, duke paguar pronarin e tyre.

Neni 8

Për parazitë të veçantë që caktohen nga ministri, shteti u siguron falas pesticidet dhe shpenzimet e nevojshme për trajtim, pronarëve që kryejnë luftimin e këtyre parazitëve.

Neni 9

Farat, fidanët, copat dhe materialet e tjera bimore që shërbejnë për mbjellje, shtim vegetativ ose trapiantim, mund të përdoren, nëse pas kontrollit fitosanitar dalin të pastra nga parazitë karantinore ose një rrezikshmërie të veçantë.

Kur materiali mbjellës del i prekur nga parazitë mbi kufijtë e lejuar nga standartet përkatëse, merren masa për riaftësimin e tij dhe, kur kjo është e pamundur, përdoret për përpunim, konsum ose asgjësohet dhe shpenzimet për këtë përballohen nga pronari i tij dhe vetëm në raste të veçanta nga shteti.

KREU III KARANTINA BIMORE

Neni 10

Importimi, eksportimi dhe kalimi tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve dhe produkteve bimore bëhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe marrëveshjet fitosanitare të lidhura me shtet dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Kalimi i tyre bëhet vetëm në pikat kufitare të kontrollit karantinor, të caktuara nga ministri në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik, Ministrinë e Transporteve e të Komunikacioneve dhe Ministrinë e Tregtisë e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë.

Neni 11

Ndalohet importimi, pranimi ose eksportimi i bimëve dhe produkteve bimore pa u kontrolluar e pajisur me çertifikatën fitosanitare përkatëse.

Bimët ose produktet bimore që kontrollohen, duhet të paraqiten në kushte të tilla që inspektori i konsideron të nevojshme për të kryer inspektimin.

Neni 12

Bimët dhe produktet bimore që importohen, kur rezultojnë të infektuara nga parazitë karantinorë, bllokohen në pikën kufitare të kontrollit karantinor nga inspektori, i cili ka të drejtë t'i kthejë mbrapsht, të bëjë riaftësimin e tyre, kur kjo është mundur, ose t'i asgjesojë në vendet e caktuara për këtë qëllim.

Shpenzimet për riaftësimin ose asgjesimin e tyre përballohen nga pronari i tyre.

Neni 13

Pronari që merret me kultivimin, prodhimin dhe magazinimin e bimëve e të produkteve bimore, kur vëren ose dyshon për një parazit të pashfaqur më parë në zonë ose për shtim masiv të një paraziti, është i detyruar të njoftojë menjëherë organet e shërbimit të mbrojtjes së bimëve për parazitin që dyshohet, si dhe të sigurojë një mostër të tij.

Neni 14

Ndalohet rritja, shtimi, kultivimi ose prodhimi i bimëve të infektuara me parazitë karantinorë.

Në rastet kur inspektori gjykon se bimët a produktet bimore janë të infektuara ose rrezikohen të infektohen me një parazit karantinor, ai ka të drejtë të ndalojë lëvizjen ose transportimin e tyre prej pronarit a personit që i ka në përdorim ato, për aq kohë sa e gjykon të nevojshme.

Neni 15

Kur një zonë del e infektuar nga një parazit karantinor, i cili mund të përhapet, inspektori shpall me shkrim se zona së bashku me të gjithë vendet kufizuese është e infektuar dhe quhet e tillë deri në një vendim tjetër të ministrit.

Kopja e shpalljes i bëhet e njohur pronarit ose përdoruesit dhe ministrit.

Kur gjykohet se paraziti mund të përhapet në ndonjë zonë tjetër, inspektori deklaron me shkrim se edhe zona tjetër është e infektuar.

Neni 16

Kur pas deklarimit sipas nenit 15, inspektori gjykon se kërkohet veprim i menjëhershëm për luftimin e një paraziti karantinor, ai ka të drejtë ta ndalojë a kufizojë për jo më shumë se 90 ditë lëvizjen e personave, të bimëve ose produkteve bimore brenda a jashtë zonës së infektuar. Me mënjanimin e shkaqeve për të cilat është bërë ndalimi ose kufizimi sipas këtij neni, inspektori anulon ndalimin ose kufizimin.

Neni 17

Ministri me urdhër mund:

- a. Të anulojë çdo zonë të deklaruar të infektuar, sipas nenit 15.
- b. Të deklarojë të infektuar çdo zonë që nuk është objekt i deklarimit sipas nenit 15.
- c. të përcaktojë dhe më pas të ndryshojë territorin e çdo zonë të deklaruar të infektuar.
- ç. Të zgjasë kohën e ndalimit ose kufizimit të deklaruar nga inspektori sipas nenit 16.
- d. Të ndalojë ose kufizojë lëvizjen e personave, të bimëve dhe produkteve bimore, brenda ose jashtë çdo zone të deklaruar të infektuar.
- e. Të lejojë çdo lëvizje personash, bimësh ose produktesh bimore, brenda ose jashtë një zone, të ndaluar nga ky nen ose neni 14 paragrafi 2.

Neni 18

Urdhri i ministrit ose i inspektorit për ndalim a kufizim sipas nenit 16 shfuqizon çdo urdhër të organeve lokale të pushtetit që bie në kundërshtim me të.

Neni 19

Inspektori ka të drejtë të bllokojë bimë ose produkte bimore, kur vëren se ka shkelje të këtij ligji. Menjëherë pas bllokimit të bimëve ose produkteve bimore inspektori njofton me shkrim pronarin ose përdoruesin e tyre për kohë dhe arsyen e bllokimit.

Neni 20

Në raste kur inspektori bën bllokimin e bimëve ose të produkteve bimore, ai e detyron pronarin ose përdoruesin e tyre që t'i magazinojë, trajtojë ose asgjesojë ato në vendin ku janë bllokuar, ose t'i lëvizë në ndonjë vend tjetër për ruajtje, trajtim ose asgjesim, duke specifikuar edhe mënyrën e veprimit.

Në çdo rast shpenzimet e nevojshme përballohen nga vetë pronari ose përdoruesi.

Neni 21

Inspektori mban të bllokuar bimë a produkte bimore ose vepron sipas nenit 20, për aq kohë sa ai e gjykon se shkelen kërkesat e këtij ligji.

Neni 22

Në rastin e bllokimit të bimëve ose produkteve bimore për qëllimet e këtij ligji, inspektorëve u sigurohet ndihma e nevojshme nga forcat e rendit.

Neni 23

Inspektori dhe organet e tjera të mbrojtjes së bimëve, për qëllimet e këtij ligji, kanë të drejtë:

a) Të kontrollojnë bimët ose produktet bimore në vendin e kultivimit të tyre, në çdo magazinë ose lokal tjetër ku ato ruhen për afate të ndryshme, si dhe në çdo mjet transporti që shërben për lëvizjen e tyre.

b) Të marrin pa pagesë me procesverbal mostra nga bimë e produkte bimore për kryerjen e analizave të nevojshme.

Neni 24

Mbajtja dhe shumëzimi i parazitëve të bimëve (të përcaktuara në nenin 3, pika a), për qëllime kërkimore dhe eksperimentale, lejohet vetëm me miratim të veçantë nga ministri.

KREU IV PËR PESTICIDET

Neni 25

Të gjitha pesticidet që destinohen të përdoren për qëllime fitosanitare në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen regjistrimit nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Dokumentimi i regjistrimit nënshkruhet nga ministri, pranë të cilit ngrihet komisioni shtetëror i pesticideve, që sugjeron mendimin teknik për miratimin ose refuzimin e regjistrimit.

Neni 26

Komisioni Shtetëror i Pesticideve e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore që dalin për këtë qëllim, si dhe me rregulloren e miratuar nga ministri. Ai funksionon nëpërmjet mbledhjeve periodike dhe sekretarisë së përhershme në Drejtorinë e shërbimit të mbrojtjes së bimëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 27

Instituti i Mbrojtjes së Bimëve bashkëpunon me Institutin e Higjienës dhe Epidemiologjisë dhe Institutin e Kërkimeve Veterinare për ndjekjen e skemës së regjistrimit të pesticideve dhe i paraqet komitetit të pesticideve propozimet përkatëse.

Neni 28

Ministri në bashkëpunim me ministrin e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit ka të drejtë të rishikojë, shtyjë, anulojë ose t'i bëjë shtesa një vendimi regjistrimi, si dhe të autorizojë, kur e gjykon të nevojshme, përdorimin e përkohshëm të një pesticidi të paregjistruar.

Neni 29

Çdo person fizik e juridik, vendas a i huaj, që kërkon të regjistrojë një pesticid është i detyruar të përballojë shpenzimet administrative të regjistrimit, shpenzimet për provat biologjiko-agronomike, mjekësore-toksikologjike dhe shpenzime të tjera për regjistrimet për marrjen e informacionit mbi efektin dhe përdorimin e këtij pesticidi.

Kuota e shpenzimeve administrative caktohet nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit dhe ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Neni 30

Personat fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj, që merren me importimin e pesticideve, duhet të jenë të pajisur me licencë të veçantë importimi të lëshuar nga ministri për afate të caktuara.

Neni 31

Ministri ka të drejtë ta bëjë të pavlefshme licencën e importimit, kur vëren shkelje të këtij ligji e të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, si dhe të shtyjë afatin e përdorimit të licencës mbi bazën e kërkesave të bëra dy muaj para skadimit të saj.

Neni 32

Personat fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj, mund të tregtojnë pesticide, pasi të jenë pajisur me licencë tregtimi të lëshuar nga Drejtoria e bujqësisë në rreth.

Neni 33

Drejtoria e bujqësisë në rreth ka të drejtë ta bëjë të pavlefshme licencën e tregtimit, kur vëren shkelje të këtij ligji e të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Neni 34

Personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që merren me importimin dhe tregtimin e pesticideve, ose personat e punësuar prej tyre, duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm për ta kryer këtë veprimtari, sipas kritereve që do të caktohen në rregullore.

Neni 35

Pesticidet rekomandohen dhe përdoren në përputhje me specifikimet e dokumentit të regjistrimit.

Neni 36

Pesticidet tregtohen vetëm në ambalazhe origjinale dhe të padëmtuara, të pajisura me etiketë në gjuhën shqipe, përmbajtja e së cilës përcaktohet kur miratohet dokumenti i regjistrimit.

Tregëtuesit e pesticideve janë përgjegjës për parametrat fiziko-kimikë të deklaruar në etiketë.

Neni 37

Instituti i Mbrojtjes së Bimëve është institucioni i ngarkuar për kontrollin cilësor të pesticideve.

Ai ka të drejtë të marrë pa pagesë prej personave fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që tregtojnë pesticide, mostra për analizën e parametrave fiziko-kimikë të deklaruar në etiketë.

Neni 38

Pesticidet transportohen, ruhen, tregtohen dhe përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve e të mjedisit dhe mbrojtjen nga zjarri.

Neni 39

Pesticidet lejohet të përdoren në sipërfaqet e mbjella me bimët e arave, pemëtari, vreshtari, pyje e kullota dhe kufizohet ose ndalohet përdorimi i tyre pranë bregut të detit, liqeneve e rezervuarëve.

Neni 40

Pesticidet e skaduara e të pavlefshme dhe ambalazhet e tyre asgjесohen në vende të përshtatshme, sipas rregullave e procedurës së përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 41

Inspektori dhe agronomi i mbrojtjes së bimëve të komunës kanë të drejtën e kontrollit në vendet e ruajtjes, të tregtimit e të përdorimit të pesticideve, si dhe në mjetet e transportit të tyre.

KREU V

ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË BIMËVE

Neni 42

Shërbimi i mbrojtjes së bimëve organizohet dhe drejtohet nga ministri, nëpërmjet organeve funksionale të këtij shërbimi (të cituara në nenet 43,44,45,46, 47).

Neni 43

Drejtoria e shërbimit të mbrojtjes së bimëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit ndjek zbatimin praktik dhe shkencor të këtij shërbimi në shkallë vendi.

Për kontrollin e zbatimit të këtij ligji funksionon Inspektoriati i mbrojtjes së bimëve dhe i

karantinës në Drejtorinë e shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe shtrihet në organet e bujqësisë në rreth e komunë.

Neni 44

Instituti i Mbrojtjes së Bimëve kryen kërkime shkencore në këtë fushë, bën diagnostikimin e prognozësinjlizimin, përpunon dhe rekomandon masat e luftimit dhe ato karantinore kundër parazitëve të bimëve, kryen provat biologjiko-agronomike për regjistrimin e pesticideve, si dhe kontrollin cilësor të tyre.

Neni 45

Inspektori i mbrojtjes së bimëve dhe i karantinës në Drejtorinë e Bujqësisë në rreth kontrollon në shkallë rrethi zbatimin e këtij ligji dhe pajis me çertifikatën fitosanitare përkatëse bimët dhe produktet bimore.

Agronomi i mbrojtjes së bimëve në laboratorin e rrethit diagnostikon, prognozësinjlizon për zhvillimin e infeksioneve të parazitëve në shkallë rrethi, si dhe këshillon masat e luftimit të tyre.

Neni 46

Agronomi i mbrojtjes së bimëve në komunë ndjek dhe evidencon gjendje fitosanitare të bimëve në komunë, ndihmon teknikisht e kontrollon zbatimin e masave të luftimit dhe administrimin e pesticideve mbi baza ligjore.

Neni 47

Inspektori i karantinës së jashtme në pikat kufitare kontrollon bimët e produktet bimore për pastërtinë nga objektet karantinore, si dhe pesticidet që importohen, dhe përcakton masat përkatëse sipas ligjit.

Kontrolli në çdo rast bëhet para shkarkimit nga mjetet e transportit (anije, vagonë, makina etj.)

Neni 48

Çdo inspektor pajiset me një dokument të nënshkruar nga ministri që vërteton emërimin e tij si inspektor dhe e paraqet atë kur kërkohet nga subjekti që kontrollohet për qëllimet e këtij ligji.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 49

Kur shkelja e dispozitave të mëposhtme nuk formon vepër penale, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet nga inspektori me gjobë 5000-20000 lekë për nenet 4, 5, 6, 7, 9, 11, 13, 14, 16, 17, 19, 20, 35, 36, 38, 39, 40, dhe 20000-50000 lekë për nenet 10, 24, 25, 30, 32.

Të drejtën e gjobës nga 1000 deri në 10 000 lekë për shkeljen e dispozitave të parashikuara në nenet 4, 5, 6, 9, 13, 14, 16, 36, 38, 39 e 40 e ka edhe agronomi i mbrojtjes së bimëve në komunë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së njoftimit të tij, te ministri për rastin e inspektorit dhe te drejtori i bujqësisë për rastin e agronomit të mbrojtjes së bimëve në komunë, aktet e të cilëve janë të formës së prerë.

Neni 50

Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij ligji caktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 51

Ligji nr.7188, datë 29.12.1987 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, shfuqizohen.

Neni 52

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.448, datë 2.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha